

Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin Drejtor i Departamentit Juridik një kandidat profesionist, i/e cila duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

| | |
|------------------|---|
| Arsimimi | <ul style="list-style-type: none">Diplome Bachelor në Shkenca Juridike në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja.Diplome Master në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja.Vlerësohen aplikantët që janë pajisur edhe me certifikata trajnimi profesional.Aftësi shumë të mira komunikimi në gjuhën Angleze në të shkruar dhe të folur.Aftësi komunikimi në një gjuhë tjetër të vendeve të Bashkimit Europian do të konsiderohet një vlerë e shtuar. |
| Eksperiencë pune | <ul style="list-style-type: none">Të paktën 15 vite eksperiencë pune përkatëse në Sektorin Juridik.Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm. |
| Cilësitë | <ul style="list-style-type: none">Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.Njohuri shumë të mira të Legjislacionit për shoqëritë Tregtare.Aftësi të mira personale për të komunikuar dhe menaxhuar mirë të gjitha nivelet e strukturave të Shoqërisë dhe aftësi të mira për të komunikuar me stafin në mënyrë të shpejtë dhe profesionale.Aftësi të mira krijuese dhe në zgjidhjen e problemeve; Aftësi për të vendosur objektiva dhe për të marrë vendime bazuar në analiza korrekte, në kohën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin financiar.Aftësi për të planifikuar, menaxhuar, ndjekjen e detyrave dhe komunikimi në të gjitha nivelet e Shoqërisë; |

- Aftësi për të trajtuar informacion konfidencial në mënyrë të ndjeshme dhe profesionale;
- Aftësi për të kryer shumë detyra, për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e kërkuara.
- Nivel i lartë integriteti dhe besueshmërie me një ndjenjë të fortë efikasiteti dhe orientimi të rezultateve;
- Aftësitë kompjuterike janë thelbësore.

Kandidatet që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që dëshirojnë të aplikojnë duhet të dërgojnë kërkesën e tyre, së bashku me CV; Fotokopje e Diplomës; Fotokopje e librezës së punës, dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. ose në adresën bnj@albpetrol.al

Kërkesat pranohen deri më datën 06.08.2020, ora 16:00.

Personat e përzgjedhur do të kontaktohen nga shoqëria Albpetrol sh.a.